



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKT VENDIM

NR. _____, DATË ____/____/2025

**PËR MIRATIMIN PËR DHENIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E
AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT "DULE"
SHPK DHE PERFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E
QENDRËS SHËNDETËSORE RRASHBULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE
RRASHBULL, BASHKIA DURRËS**

Nëmbështetjetënenit 113, pika 2 tëKushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 tëLigjit nr. 139/2015. "Përvetëqeverisjenvendore", tëndryshuar,VendimittëKëshillittëMinistravenr. 1003, datë 10.12.2010, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit". kërkesës që mban nr. 88 prot., datë 01.10.2024 të subjektit "Dule" shpk, administruar nga Bashkia me nr. 14094 prot., datë 04.12.2024, me anë të së ciles shprehet vullneti për të rikonstruktuar Qendren ShëndetësoreRrashbull, Njësia Administrative Rashbull, Bashkia Durrës, shkresës nr. 570/3 prot., datë 04.12.2024, ardhur nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, e protokolluar në Bashki me nr.14230 , datë 06.12.2024, me lëndë: "Përcjellje dokumentacioni" ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", I ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015. "Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, kryetari i Bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak.

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për dhënie e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet Sipërmarrësit "Dule" shpk dhe përfituesit BashkiaDurrës, për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rashbull, Njësia Administrative Rashbull, Bashkia Durrës, qëmban nr. 15 tëlistës së transferimit, miratuar me VKM-në nr. 1003, datë 10.12.2010, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit".

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Projekteve Investimeve Publike dhe Njësia Administrative Rrashbull për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE


Drejtor

Alceida Rroshi



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

RELACION

**PËR MIRATIMIN PËR DHENIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E
AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE”
SHPK DHE PERFITUESIT BASHKIA Durrës, PËR RIKONSTRUKSIONIN E
QENDRËS SHËNDETËSORE RRASHBULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE
RRASHBULL, BASHKIA Durrës**

Para Këshillit Bashkiak

K ë t u

Të nderuar këshilltarë,

Projektvendimi që po ju paraqesim për shqyrtim e miratim, ka për qëllim fillimin e procedurave për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Sipërmarrësit “Dule” sh.p.k. për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës.

Godina që kërkohet të rikonstruktohet me donacion (jo nga fondet e Qeverisë Shqiptare), është pronë e Bashkisë Durrës, e kaluar kjo me VKM-në nr. 1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”, dhe mban nr.15 të listës së transferimit. Qendra Shëndetësore Rrashbull prej shumë vitesh i shërben zonës së Rrashbullit, e cila ka të regjistruar rreth 6000 banorë. Kjo Qendër është tejet e amortizuar. Prej vitesh në këtë ndërtesë nuk është kryer asnjë investim për rikonstruksion, nuk është kryer asnjë investim për mirëmbajtjen e saj, duke sjellë amortizimin e ndërtesës. Godina, aktualisht nuk përmbush kushtet për një shërbim bashkëkohor të popullsisë së zonës.

Rezulton se kohët e fundit ka shprehur interesim subjekti ndërtues “Dule” sh.p.k, me NIPT J82401502P, me adresë lagjia nr. 13, rruga “Lule Bora”, Plazh, Durrës, me administrator z. Mitat Dule, i cili me një kërkesë drejtuar Bashkisë Durrës, që mban nr. 88 prot., datë 01.10.2024, shpreh interesin për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, duke vënë në dispozicion dhe projektin e rikonstruksionit. Fondet prej 43.000 euro për rikonstruksionin e Qendrës do të jepen nga Shoqata “Agimi Bolzano ODV”, me qendër në Bolzano, Itali, i cili shpreh interesin për të investuar edhe në rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës. Koha e përfundimit të rikonstruksionit do të jetë sipas afateve të përcaktuar në lejen e zhvillimit që do të jepet nga bashkia.

Me shkresen nr. 570/3 prot., datë 04.12.2024, ardhur nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, e protokolluar në Bashki me nr. 14230, datë 06.12.2024, me lëndë: "Përcjellje dokumentacioni", percillet shkresa nr. 4683/1 prot., datë 27.11.2024 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me anë të së cilës shprehet miratimi në parim për realizimin e këtij investimi.

Projekti i paraqitur nga subjekti "Dule" Sh.p.k. paraqet konstruksionin e godinës ekzistuese, 1 KT, me sipërfaqe të përgjithshme 200.08 m², ku sipërfaqe ndërtimore 105 m² me ambiente funksionale, me vlerë sipas preventivit të paraqitur 43.000 Euro. Kjo vlerë do të paguhet nga donatori "Agimi Balzano", e do ti jepet investitorit "Dule" shpk., gjatë periudhës 2024-2025.

Preventivi për Rikonstruksionin e kësaj Qendre Shëndetësore përfshin një sërë punimesh të pasqyruara në Preventivin me objekt: "Qendër Shëndetësore Rrashbull" i vënë në dispozicion nga subjekti "Dule" shpk.

Burimet financiare për rikonstruksionin e kësaj Qendre Shëndetësore do të sigurohen nga Shoqata "Agimi Bolzano", me seli në Via Piani d'Isarco 6/c, Bolzano, Itali, kjo dhe sipas kontratës që mban datën 11.9.2024, i hartuar në gjuhën Italiane dhe përkthyer në shqip dhe e konfirmuar nga zyra noteriale që mban nr. rep.5239, datë 03.10.2024, Tiranë. Edhe garancia për fondet është konfirmuar nëpërmjet një deklarate ku deklarohet se kontributi i marrë nga Shoqata "Agimi Bolzano ODV" për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Shkallnur është disbursuar nga Rajoni Trentino Ato Adige, bazuar në projektin e bashkëpunimit për zhvillimin e vendeve jashtë Bashkimit Europian. Edhe ky dokument është përkthyer në gjuhën shqipe dhe e vërtetuar për përkthimin nga zyra vendore e noterisë Tiranë.

Sqarojmë këshilltarët se donatori Shoqata "Agimi Bolzano", është një Shoqatë jofitimprurëse, e krijuar me Vendim të Institucioneve të shtetit Italian. Ajo ka për mision kontributin e saj në ndihmë për zhvillimin e vendeve Extra BE. Kjo Shoqatë, për realizimin e qëllimit për të cilën është krijuar, ku përfshihen dhe ndërtime publike, bëshkëpunon ndërmjet të tjerave dhe me subjekte ndërtues, ku për rastin tonë është subjekti "Dule" Sh.p.k.

Në marrëveshje, ndërmjet të tjerave do të përcaktohet se granti që do të shfrytëzohet për kostot e ndërtimit dhe shpenzimet e tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar, si për detyrimet e projektit, detyrimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore, TVSH-të, taksat, tatimet, detyrimet, tarifat, zbritjet, shumat e mbajtura, që do të merren përsipër nga subjekti "Dule" Sh.p.k. në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Subjekti "Dule" Sh.p.k. ka të drejtë të rishikojë të gjitha dokumentet, pasqyrat bankare, faturat, raportet, rekomandimet dhe korrespondencat e tjera, printimet dhe të dhënat në lidhje me objektin e marrëveshjes.

Bashkia ka për detyrim t'u sigurojë konsulentëve dhe kontraktuesve të Objektit (Qendra Shëndetësore), pa asnjë pengesë, mbështetje me qellim zbatimin e projektit.

Kërkesa jonë për miratimin e marrëveshjes së grantit gjen zbatim dhe në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ku neni 22 i ligjit, "Parimet për ushtrimin e funksioneve", përcakton se: "... Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.... Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikën kombëtare dhe rajonale...". Ndërsa neni 23 i ligjit,

“Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, përcakton se: “... Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ... Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...”.

Të nderuar këshilltarë,

Nëse do të merret vendim për miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Bashkisë Durrës dhe subjektit “Dule” sh.p.k., për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, mendojmë se do të zgjidhen dhe këto probleme:

- Zona e fshatit Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, do të bëhet me Qendër Shëndetësore të rikonstruktuar dhe me kushte të përshtatshme për personelin dhe pacientët.
- Bashkia përfiton falas nga donatori një objekt të rikonstruktuar.
- Godina e rikonstruktuar do të jetë brenda standarteve dhe kushteve gjeologjike, sizmike dhe teknike sipas normave dhe Kodit European të Projektimit.
- Realizohet një detyrim ligjor i parashikuar në ligj që ka bashkia për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor, e përcaktuar kjo në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur relacionit aktet e mëposhtme:

- VKM-ja nr. 1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit”.
- Formulari i inventarizimit ku prona objekt shqyrtimi mban nr. 15 të listës së transferimit.
- Plan Rilevimi i pronës që kërkohet të rikonstuktohet.
- Kërkesë e subjektit ndërtues “Dule” sh.p.k., drejtuar Bashkisë Durrës, që mban nr. 88 prot., datë 01.10.2024, me anë të së cilës shprehet interesimi për të financuar në Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës.
- Projekti për rikonstuksionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, i hartuar nga investitori “Dule” shpk.
- Shkresa nr. 570/3 prot., datë 04.12.2024, ardhur nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, e administruar në Bashki me nr. 14230, datë 06.12.2024, me lëndë: “Përcjellje dokumentacioni”.
- Shkresa nr. 4683/1 prot., datë 27.11.2024, dalë nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, drejtuar Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës.
- Marrëveshje bashkëpunimi e lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës në cilësinë e porositësit dhe subjektit ndërtues “Dule” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit.

- Kontrata që mban datën 11.9.2024, me objekt: Rikonstrukcion i Qendrës Shëndetësore Rrashbull, nënshkruar ndërmjet Donatorit, Shoqata Humanitare "Agimi Bolzano", Itali, përfaqësuar nga presidenti z. Roberto Cucchiaro, regjistruar me Kodin Fiskal të Shoqatës me Nr. 94071030210, me adresë: Via Piani d'Isarco 6/C – 39100 Bolzano, Itali dhe Sipërmarrësit, Shoqërisë "Dule" shpk, me NUIS: J82401502P, me administrator të shoqërisë Mitat Dule, me adresë Lagjia nr. 13, Plazh, Rruga: "Lulebore", Durrës, Shqipëri.
- Preventivi i punimeve për Rikonstrukcionin e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, Bashkia Durrës.
- Dokumentacioni ligjor i subjektit "Dule" shpk si: Çertifikatë regjistrimi; Ekstrati I regjistrimit tregtar; Vertetim i Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Durrës, që mban nr. T82401502P, date printimi 11.12.2024, ku vertetohet se subjekti "Dule" shpk, me administrator z. Mitat Dule, nuk ka detyrime të palikujduar; Printim nga sistemi për taksat vendore, ku provohet se subjekti "Dule" shpk nuk ka detyrime ndaj Taksave e Tarifave Vendore; Vertetim që mban datën 10.01.2025, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku vertetohet se z. Mitat Dule nuk ndodhet në proces gjyqësor penal; Konfirmim që mban nr.774 prot., datë 20.12.2024, datë nga Credins Bank ku konfirmohet vlera e depozituar nga subjekti Mitat Dule, që është disponibel.

**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE
DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE**

Pranvera Gagani



DREJTORIA LIGJORE

Drejtore

Alneida Rroshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1003, datë 10.12.2010

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS RASHBULL, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rashbull, të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes 1 e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Rashbull, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.1153, datë 13.8.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rashbull, të qarkut të Durrësit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Rashbull për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



LULZIM BASHA

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
12-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
18-31	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
32-45	Varreza publike.	Në pronësi
46-51	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
94,99,105,109,110,111, 113-116	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi

MINISTRI

LULZIM BASHA

